# S T A T U T I   I   S H O Q E R I S E   A N O N I M E

Themeluesit deklarojne, se krijojne Shoqerine Anonime e cila me poshte do te quhet "Shoqeria".

## KREU I

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### Neni 1

Themeluesit e "Shoqerise" jane :

1. **Kantieri Detar Durres** - me qender ne **Durres** - Republika e Shqiperise.

2. Gdanska Stocznia Remontowa im. J. Pilsudskiego - me qender ne Gdansk - Republika e Polonise.

### Neni 2

"Shoqeria" krijohet si person juridik dhe fiton te drejtat e personit juridik, qe nga dita e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar te Republikes se Shqiperise.

### Neni 3

"Shoqeria" zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj, Statutin dhe Kontraten.

### Neni 4

1. Emertimi i "Shoqerise" do te jete :

- ne shqip : KANTIERI DETAR DURRES-GDANSK, SH.A.
- ne polonisht : STOCZNIA DURRES-GDANSK, S.A.
- ne anglisht : SHIPYARD DURRES-GDANSK, S.A.

2. Selia e "Shoqerise" do te jete ne qytetin e Durresit, ne Republiken e Shqiperise.

3. "Shoqeria" mund te formoje dege ose perfaqesine ne vend ose jashte shtetit.

4. Koha e veprimtarise se "Shoqerise" eshte e pakufizuar.

Neni 5

Objekti i veprimtarise se "Shoqerise" eshte :

a) Riparimi, ndertimi dhe rindertimi i njesive lundruese.

b) Prodhimi i paisjeve te njesive lundruese.

c) Eksporti i prodhimeve te saj.

d) Ndertimi i konstruksioneve te celikut, drurit dhe materialeve plastika.

e) Kryerja e tregtise me prodhimet e veta dhe furnizimi pa ndermjetes ne vend dhe jashte shtetit.

f) Prodhime industriale te ngjashme me ndertimin e njesive lundruese dhe te elementeve te tyre.

g) Veprimtari transporti.

h) Kryerja e sherbimeve industriale.

i) Veprimtari turistiko-hoteljera per punonjesit e "Shoqerise" .

KREU II

KAPITALI THEMELTAR DHE AKSIONET

Neni 6

1. Kapitali themeltar ( "Shoqerise" eshte 8.000.000 (tete milion) dollare USA qe eshte e barabarte me 864 (teteqind e gjashtedhjete e kater) milion Leke shqiptare dhe ndahet ne 80.000 aksione nominative, me vlere nominale 100 dollare USA sejcili.

2. Aksionet do te mbulonen me kontribute ne natyre dhe ne para.

3. Te gjitha aksionet themeluese jane nominative dhe te pathyeshme kundrejt "Shoqerise".

4. Aksionet do te mbulohen ne menyren e meposhteme :

4.1. Kantieri Detar Durres zoteron 39.200 (tridhjete e nente mije e dyqind) aksione me nga 100 dollare USA sejcili, me vlere te pergjithshme 3.920.000 (tre milion e nenteqind e njezet mije) dollare USA, qe eshte e barabarte me 423.360.000 (katerqind e njezetetre milion e treqind e gjashtedhjete mije) Leke, qe perbejne 49 (dyzet e nente) % te kapitalit themeltar te "Shoqerise", te perbere prej kontributit ne natyre te percaktuar ne aneksin nr. 1 te Kontrates dhe kontributit ne para ne shumen 3.240.000 (tre milion e dyqind e dyzet mije) Leke, qe pas llogaritjeve eshte 30.000 (tridhjete mije) dollare USA.

4.2. Gdanska Stocznia Remontwa im. J. Pilsudskiego, zoteron 40.800 (dyzet mije e teteqind) aksione me nga 100 dollare USA sejcili me vlere te pergjithshme 4.080.000 (kater milion e tetedhjete mije) dollare USA qe eshte e barabarte me 440.640.000 (katerqind e dyzet milion e gjashteqind e dyzet mije) Leke qe perbejne 51 (pesedhjete e nje) % te kapitalit themeltar te "Shoqerise", te perbere prej kontributit ne natyre te percaktuar ne aneksin nr. 2 te Kontrates, kontributit ne para ne shumen 200.000 (dyqind mije ) dollar USA dhe kontributit ne forme te shpenzimeve te shkollimit te punonjeseve shqiptar te percaktuar ne aneksin nr. 6, pika II, te Kontrates.

5. Vleresimi i vleres se kontributeve ne natyre per cdo ortak eshte bere ne perputhje me marreveshjen dy paleshe qe perben aneksin nr.3 te Kontrates. Madhesia dhe menyra e llogaritjes se kontributeve jane perfundimtare dhe nuk do te diskutohen me

ndermjet ortakeve.

Perllogaritja e dollareve USA ne Leke dhe Lekeve ne dollare USA eshte kryer ne baze te kursit zyrtar te Bankes se Shqiperise ne diten e nenshrimit te Kontrates.

Neni 7

1. Aksionaret kane te drejte te marrin pjesen e fitimit tor, te destinuar nga Asambleja e aksionareve per ndarje.

2. Fitimi ndahet ne raport me vleren nominale te aksioneve.

3. Pjesa e fitimit, qe i takon Gdanska Stocznia Remontowa im. J. Pilsudskiego mund te transferohet lirisht jashte shtetit ne valute te kembyeshme sipas legjislacionit shqiptar, pasi te jene paguar taksat ne Shqiperi.

Neni 8

1. Aksionet jane te transferueshme.

2. Transferimi i pronesise se aksioneve nominative, kerkon lejen me shkrim te Keshillit Mbikqyres.

3. Paresia ne transferimin e aksioneve nominative ju takon aksionareve te tjere te "Shoqerise", sipas rradhes se paraqitjes se ofertes dhe ne rast te paraqitjes te njehershme te ofertes, i takon Keshillit Mbikqyres te vendose per caktimin e rradhes.

4. Keshilli Mbikqyres cakton bleresin gjate tre muajve, llogaritur nga data e paraqitjes se ofertes te transferimit te aksioneve. Ne rast se Keshilli Mbikqyres nuk cakton gjate kesaj periudhe bleresin, pronari i aksionit mund t'i shese ato nje personi te cfardoshem fizik ose juridik me cmim te lire, por jo me te ulet nga ai i ofruar ortakeve.

5. Ne rast se bleresin e cakton Keshilli Mbikqyres, cmimi i shitjes se aksioneve nominative do te caktohet sipas vleres aktuale te bilancit te "Shoqerise".

# KREU III

## DREJTIMI I "SHOQERISE"

### 1 Drejtoria

### Neni 9

### Perberja e drejtorise dhe kontrolli mbi te.

Drejtoria e "Shoqerise" perbehet nga drejtori dhe dy zv/drejtora.

Drejtori eshte i shtetesise shqiptare, ndersa zv/drejtorat te shtetesise polake.

Drejtoria ushtron funksionet e saj nen kontrollin e Keshillit Mbikqyres.

### Neni 10

### Emerimi i anetareve te drejtorise.

Anetaret e drejtorise emerohen nga Keshilli Mbikqyres qe zgjedh njerin prej tyre me cilesine e drejtorit.

Anetaret e drejtorise jane persona fizike.

Kontraten e punes me anetaret e drejtorise se "Shoqerise", e lidh ne emer te "Shoqerise", perfaqsuesi i Keshillit Mbikqyres i caktuar ndermjet anetareve te tij.

### Neni 11

### Shkarkimi i anetareve te drejtorise.

Anetaret e drejtorise, mund te shkarkohen per shkaqe te perligjura, nga Keshilli Mbikqyres.

### Neni 12

### Kohezgjatja e mandateve te anetareve te drejtorise dhe shperblimi i anetareve te drejtorise.

Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe prej tre

vjetesh dhe mund te riemerohen. Aktin e emerimit e nenshkruan kryetari i Keshillit Mbikqyres. Ne te fiksohet menyra dhe masa e shperblimit te sejcilit anetar te drejtorise.

Neni 13

Kompetencat e drejtorise dhe marrja e vendimeve nga drejtoria. Perfaqesimi tek te tretet.

Drejtoria ka kompetenca te plota, per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te "Shoqerise". Ajo i ushtron keto kompetenca brenda objektit te veprimtarise se "Shoqerise", por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji "Per shoqerite tregtare te Republikes se Shqiperise" u a jep shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe Asamblese te Aksionareve.

Drejtoria shqyrton dhe merr vendime sipas kushteve te caktuara ne kete statut.

Drejtoria raporton per veprimtarine e saj dhe pergjigjet para Keshillit Mbikqyres per realizimin e qellimeve dhe angazhimeve qe jane ne kompetencen e saj.

Drejtoria perfaqson "Shoqerine" perpara te treteve, ne gjykata dhe arbitrazhe, administron pasurine dhe interesat e saj, me perjashtim te kompetencave qe u takojne organeve te tjera te "Shoqerise".

Klauzolat e Statutit qe kufizojne kompetencat e drejtorise duhet te respektohen nga te tretet.

Per kryerjen e veprimeve juridike ne emer te "Shoqerise" eshte i domosdoshem bashkeveprimi i dy anetareve te drejtorise, ose i nje anetari te drejtorise dhe personit te autorizuar me vendim te drejtorise.

Per marrjen e angazhimeve vlera e te cilave kalon 2 % te

vjetesh dhe mund te riemerohen. Aktin e emerimit e nenshkruan kryetari i Keshillit Mbikqyres. Ne te fiksohet menyra dhe masa e shperblimit te sejcilit anetar te drejtorise.

Neni 13

Kompetencat e drejtorise dhe marrja e vendimeve nga drejtoria. Perfaqesimi tek te tretet.

Drejtoria ka kompetenca te plota, per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te "Shoqerise". Ajo i ushtron keto kompetenca brenda objektit te veprimtarise se "Shoqerise", por kufizohet nga ato kompetenca qe ligji "Per shoqerite tregtare te Republikes se Shqiperise" u a jep shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe Asamblese te Aksionareve.

Drejtoria shqyrton dhe merr vendime sipas kushteve te caktuara ne kete statut.

Drejtoria raporton per veprimtarine e saj dhe pergjigjet para Keshillit Mbikqyres per realizimin e qellimeve dhe angazhimeve qe jane ne kompetencen e saj.

Drejtoria perfaqson "Shoqerine" perpara te treteve, ne gjykata dhe arbitrazhe, administron pasurine dhe interesat e saj, me perjashtim te kompetencave qe u takojne organeve te tjera te "Shoqerise".

Klauzolat e Statutit qe kufizojne kompetencat e drejtorise duhet te respektohen nga te tretet.

Per kryerjen e veprimeve juridike ne emer te "Shoqerise" eshte i domosdoshem bashkeveprimi i dy anetareve te drejtorise, ose i nje anetari te drejtorise dhe personit te autorizuar me vendim te drejtorise.

Per marrjen e angazhimeve vlera e te cilave kalon 2 % te

kapitalit themeltar, eshte i domosdoshem bashkeveprimi i dy anetareve te drejtorise, njeri prej te cileve duhet te jete drejtori

Vendimet qe i perkasin ceshtjeve vecanerisht te rendesishme per kolektivin (te permendura me poshte) merren ne mbledhjen e drejtorise me shumicen e thjeshte te votave, me kusht qe njera keto vota te jete e drejtorit.

Ne keto ceshtje perfshihen :

- niveli i punesimit dhe i pagave
- rregullorja e drejtorise dhe rregullorja organizative e "Shoqerise".
- kushtet social-jetesore te punonjesve.

Ankesat apo kerkesat qe te tretet i adresojne "Shoqerise" jane te vlefshme vetem kur ato dergohen tek drejtori.

Anetari i drejtorise pa lejen e "Shoqerise" nuk mund te merret me interesa konkurimi, as edhe te marre pjese ne nje shoqeri konkuruese si ortak. Anetari i drejtorise nuk mund te jete i punesuar ne nje institucion tjeter ( ne shoqerira, ndermarrje shteterore ose uzina pune te nje tipi tjeter) as te kryej ne to ndonje funksion qofte edhe pa shperblim.

Vendimet e drejtorise duhet te protokollohen. Pervec kesaj protokollet duhet te permbajne rendin e dites se punimeve, emrat dhe mbiemrat e anetareve te pranishem te drejtorise, numrin e votave te dhena per vendimet e vecanta si dhe pikpamjet e ndryshme. Protokollin e nenshkruajne te pranishmit ne mbledhje.

## 2. Keshilli Mbikqyres

### Neni 14

### Kompetencat

Keshilli Mbikqyres ushtron kontroll ndaj drejtorise per administrimin e "Shoqerise" nga ana e saj.

Perfundimi i operacioneve te parashikuara ne Statut, qe jane kompetence e Keshillit Mbikqyres mund te behet vetem me autorizim paraprak te Keshillit Mbikqyres.

Tejkalimi i kompetencave te ketij autorizimi, duhet te respektohet nga te tretet, qe nuk kane pasur dijeni per te.

Keshilli Mbikqyres ka te drejte te kryej ne cdo kohe, verifikime dhe kontrolle, qe ai i gjykon te nevojshme, dhe te kerkoje te njihet me dokumentet qe ai i gjykon te nevojshme per plotesimin e detyres se tij.

Drejtoria i paraqet raport Keshillit Mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj.

Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar drejtoria i paraqet Keshillit Mbikqyres dokumentet e llogarise vjetore dhe ne rast se eshte e nevojshme, cdo lloj dokumenti, me qellim verifikimi dhe kontrolli.

Keshilli Mbikqyres i paraqet Asamblese ne mbledhjen vjetore, verejtjet e tij mbi raportin e drejtorise si edhe ato mbi llogarite e vitit financiar.

Mbledhjen e Keshillit Mbikqyres e therret kryetari i keshillit :

- me inisiativen e vet,
- me propozimin me shkrim te nje antari te Keshillit Mbikqyres,
- me propozimin me shkrim te drejtorise.

Mbledhja duhet thirrur brenda 30 diteve nga momenti i paraqitjes te propozimit.

Keshilli Mbikqyres miraton rregulloren e tij, e cila trajton me hollesi menyren e veprimit.

Keshilli Mbikqyres delegon antarin ose antaret e tij, per [illegible] e perkohshme te detyrave te drejtorise se "Shoqerise" ne [illegible] drejtorise, ose kur per aresye te tjera drejtoria nuk mund te funksionoje.

### Neni 15

### Perberja

Keshilli Mbikqyres perbehet prej 6 (gjashte ) antaresh. Nga keta, 3 (tre) antare jane me shtetesi polake dhe 3(tre) te tjere jane me shtetesi shqiptare.

[illegible] 5 (pese), ndersa numri minimal ligjor eshte 4 (kater).

Asnje antar i Keshillit Mbykqyres nuk mund te jete antar i drejtorise.

### Neni 16

### Caktimi i drejtuesve te pare te Keshillit Mbikqyres dhe te eksperteve te pare kontabel te autorizuar.

Antaret e pare te Keshillit Mbikqyres dhe ekspertet e pare kontabel te autorizuar caktohen ne Statut nga themeluesit e "Shoqerise".

Konkretisht ato jane :

Keshilli Mbikqyres

1. PIOTR SOYKA
2. MARIAN ZELEK
3. STANISLAW PSZCZOLKOWSKI
4. MIHAL BOZDO
5. ARBEN GOLASHI
6. ARDIAN HAXHIHYSENI

[illegible] kontabel te autorizuar

1. LEON D@MARADZKI me shtetesi polake
2. LUAN FISHTA me shtetesi shqiptare
3. RIFAT FANI me shtetesi shqiptare

Keshilli i pare Mbikqyres i caktuar ne Statut, jo me vone se [illegible] dite perpara regjistrimit te "Shoqerise" ne Regjistrin Tregtar Shqiptar, zgjedh nga gjiri i tij kryetarin, zv/kryetarin si dhe emeron anetaret e drejtorise.

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres dhe ekspertet e pare kontabel te autorizuar caktohen per nje afat prej 3 (tre) vjetesh.

Pas perfundimit te afatit te anetareve te pare te Keshillit Mbikqyres dhe eksperteve te pare kontabel te autorizuar, te caktuar ne Statut, emerimi dhe zgjedhja e rradhes e tyre behet ne perputhje me nenet e meposhteme.

Nene 17

Emerimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres dhe kohezgjatja e funksioneve te tyre.

Dy te tretat te anetareve te Keshillit Mbikqyres, qe jane kater anetare, emerohen nga mbledhja themeluese e Asamblese ose nga mbledhja e zakonshme e Asamblese Aksionare. Tre prej tyre jane shtetas polak dhe nje me shtetesi shqiptare. Kohezgjatja e funksioneve te ketyre anetareve te Keshillit Mbikqyres eshte tre vjet.

Anetaret mund te rizgjidhen. Ata mund te shkarkohen ne cdo moment nga Asambleja e zakonshme e aksionareve.

I punesuari ne "Shoqeri" nuk mund te jete anetar i Keshillit Mbikqyres te emeruar nga Asambeja e aksionareve.

## Neni 18

## Vendet bosh

Ne rastin e vendeve bosh qe krijohen nga vdekja apo dorebeqja e nje ose disa antareve te Keshillit Mbikqyres, ky Keshill mundet per periudhen ndermjet dy mbledhjeve te Asambles, te beje emerime te perkohshme.

Kur numri i antareve te Keshillit Mbikqyres ka zbritur nen minimumin ligjor, drejtoria duhet te therrase urgjentisht mbledhjen e Asamblese se zakonshme per te plotesuar efektivin e Keshillit Mbikqyres.

Kur numri i antareve te Keshillit Mbikqyres ka zbritur nen minimumin e kerkuar ne statut, por eshte jo me i vogel se minimumi ligjor, Keshilli Mbikqyres, brenda 3 muajve nga data e krijimit te vendeve bosh, duhet te beje emerime te perkohshme per te kompletuar efektivin e tij.

Emerimet e bera nga Keshilli, ne baze te paragrafeve 1 dhe 3 te ketij neni i nenshtrohen ratifikimit ne mbedhjen e radhes se Asambles se zakonshme. Ne mungese te ratifikimit, shqyrtimet e bera dhe vendimet e marra me pare nga Keshilli mbeten te vlefshme.

## Neni 19

## Anetaret e zgjedhur nga te punesuarit dhe kohezgjatja e mandatit te tyre.

Nje e treta e anetareve te Keshillit Mbikqyres, qe jane dy anetare, zgjidhet nga te punesuarit ne "Shoqeri". Ata jane me shtetesi shqiptare.

Nga dy antare te zgjedhur nga te punesuarit ne "Shoqeri", te pakten njeri nga keta duhet te jete inxhinier, kuader ose person i ngjashem me ta.

Kohezgjatja e mandatit te antareve te zgjedhur nga te punesuarit ne "Shoqeri" eshte tre vjet.

## Neni 20

## Kryetari dhe zv/kryetari i Keshillit Mbikqyres

Keshilli Mbikqyres zgjedh nga gjiri i tij kryetarin dhe nje zv/kryetar qe ngarkohen me mbledhjen e Keshillit dhe drejtimin e debatit gjate seancave te tij. Keshilli Mbikqyres cakton, ne qofte se keshiron shperblimin e tyre.

Kryetari i Keshillit Mbikqyres eshte i shtetesise polake, ndersa zv/kryetari eshte i shtetesise shqiptare. Ata ushtrojne funksionet e tyre gjate tere periudhes se mandatit te Keshillit Mbikqyres.

## Neni 21

## Quorumi dhe shumica per marrjen e vendimit

Per vlefshmerine e vendimeve te Keshillit Mbikqyres, kerkohet qe te ftohen ne mbledhje te gjithe antaret e tij dhe te jene te pranishem te pakten gjysma e numrit te antareve.

Keshilli Mbikqyres merr vendime me shumice te thjeshte votash te antareve te pranishem ose te perfaqesuesve te tyre, me perjashtim te ceshtjeve te meposhteme, per te cilat kerkohet jo me pak se 3/4 e votave :

- Dhenia dhe marrja e kredive ne leke e ne valute te huaj per nje shume me te madhe se 1 perqind te kapitalit themeltar

- Lidhja e kontratave me vlere me te madhe se 4 perqind te kapitalit themeltar.

- Miratimi i autorizimit per formimin e degeve te reja te "Shoqerise"

- Emerimin e antareve te drejtorise.

Vota e kryetarit eshte percaktuese ne rast rezultati te barabarte te votave.

Neni 22

Shperblimi i vecante per pjesemarrjen ne Keshillin Mbikqyres dhe shperblime te jashtezakonshme

Asambleja mund t'u caktoje antareve te Keshillit Mbikqyres shperblim nje shume vjetore fikse per pjesemarrjen e tyre ne seancat e ketij Keshilli.Kete shume Asambleja e percakton pamvaresisht nga dispozitat e Statutit apo nga vendimet e meparshme. Shperblimet e antareve te Keshillit Mbikqyres perballohen nga llogaria e "Shoqerise".

Keshilli Mbikqyres mund te percaktoje shperblime te jashtezakonshme per sherbimet apo detyrat qe u besohen anetareve te Keshillit Mbikqyres.Ne kete rast keto shperblime qe perballohen nga llogaria e "Shoqerise" i nenshtrohen rregullavete nenit 23 dhe dispozitave te tjera te ligjit "Per Shoqerite Tregtare te Republikes se Shqiperise".

Anetaret e Keshillit Mbikqyres, me perjashtim te atyre qe zgjidhen nga te punesuarit, nuk mund te marrin prej "Shoqerise" asnje shperblim pervec atere qe parashikohen ne nenin 20 dhe ne paragrafin 1 dhe 2 te ketij neni. Cdo klauzole qe bie ne kundershtim me kete nen nuk merret parasysh dhe cdo vendim i kundert konsiderohet i pavlefshem.

3. Dispozita te pergjithshme

Neni 23

Mareveshje qe kerkojne autorizim.

Mareveshjet qe kerkojne autorizim paraprak te Keshillit Mbik-

qyres jane :

- te gjitha marreveshjet qe behen ndermjet "Shoqerise" dhe nje antari te drejtorise apo te Keshillit Mbikqyres te kesaj "Shoqerie".

- marreveshjet, me te cilat nje nga personat e siperpermendur lidhet indirekt, apo ne te cilat ai lidhet me "Shoqerine" ndermjet nje personi ndermjetes,

- marreveshje qe veprojne nepermjet "Shoqerise" dhe nje subjekti tjeter ekonomik te nje lloji te cfardoshem, ne rast se nje nga antaret e drejtorise apo te Keshillit Mbikqyres te "Shoqerise" eshte pronar, ortak "i pakufizuar", administrator apo antar i drejtorise te subjektit tjeter ekonomik.

Rregullat e ketij neni nuk zbatohen per marreveshjet e bera rreth operacioneve te perditeshme dhe te zbatuara ne kushte normale.

Kontrolli mbi marreveshjet, kundershtueshmeria e marreveshjeve dhe pavlefshmeria e marreveshjes, zgjidhet sipas neneve 123, 124 dhe 125 te ligjit "Per Shoqerite Tregtare te Republikes se Shqiperise".

## Neni 24

## Detyrimi per fshehtesi

Anetaret e drejtorise dhe te Keshillit Mbikqyres, si dhe cdo person qe thirret te marre pjese ne mbledhjet e ketyre organeve, duhet te ruajne fshehtesine per te dhenat qe kane karakter te brendshem dhe qe cilesohen si te tilla nga kryetari.

KREU IV

Asambleja e aksionareve

Neni 25

Asambleja e jashtezakonshme

Vetem Asambleja e jashtezakonshme ka kompetenca te ndryshoje Statutin me te gjitha dispozitat e tij.

Asambleja e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se aksionaret e pranishem ose te perfaqsuar zoterojne ne mbledhjen e pare te pakten 1/2 e aksioneve dhe ne te dyten 1/4 e aksioneve me te drejte vote. Ne mungese te ketij quorumi, mbledhja e dyte e Asamblese mund te shtyhet per nje date te me vonshme, jo me te larget se dy muaj nga data e thirrjes se mbledhjes se pare.

Asambleja e jashtezakonshme merr vendim me nje shumice votash prej 3/4, qe u perkasin aksionareve te pranishem ose te perfaqsuar.

Neni 26

Asambleja e zakonshme

Asambleja e zakonshme merr cdo vendim per vec atyre qe permendem ne nenin 25.

Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem ne qofte se aksionaret e pranishem ose te perfaqsuar, zoterojne te pakten 1/4 e aksioneve me te drejte vote. Ne rast se kjo mbledhje nuk realizohet, ne te dyten nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksionaret e pranishem ose te perfaqsuar.

## Neni 27

### Mbledhja e Asamblese se zakonshme

Asambleja e zakonshme thirret ne mbledhje te pakten nje here ne vit, brenda kater muajve qe pasojne mbylljen e vitit financiar Ky afat mund te zgjatet me vendim gjyqsor.

Pas leximit te raportit, drejtoria i paraqet Asamblese llogarite vjetore dhe, ne rast se eshte e nevojshme, llogarite e konsoliduara.

Pervec te tjerave, ekspertet kontabel te autorizuar paraqesin raportin per kryerjen e detyres se ngarkuar sipas kerkesave te ketij Statuti.

Asambleja shqyrton dhe vendos mbi te gjitha ceshtjet financiare te vitit financiar qe ka kaluar.

Asambleja autorizon emetimin e obligacioneve dhe nxjerrjen e akteve te vecanta te sigurimit qe lidhen me to.

## Neni 28

### Thirrja e mbledhjes se Asamblese

Mbledhja e Asamblese thirret nga Keshilli i Mbikqyrjes ose nga drejtoria.

Ne mungese te tyre ajo mund te thirret gjithashtu :

1. Nga ekspertet kontabel te autorizuar.

2. Nga nje mandatmbajtes, i caktuar nga gjyqi, me kerkesen e cdo personi te interesuar per nje rast urgjent, ose te nje apo disa aksionareve qe zoterojne se bashku te pakten 1/10 e kapitalit themeltar.

3. Nga likujduesit.

Mbledhjet e Asamblese te aksionareve mbahen ne seline e "Shoqerise" dhe nje here ne pese vjet mund te mbahen ne Gdansk,

Republika e Polonise.

## Neni 29

## Menyra e njoftimit

Thirrja e mbledhjeve te Asamblese se aksionareve behet nepermjet lajmerimit te botuar ne gazetat e autorizuara per publikime dhe lajmerime zyrtare ne Shqiperi dhe Poloni.

Aksionaret qe posedojne te pakten 1/10 e kapitalit aksionar, njoftohen me leter te porositur ne adrese te aksionarit me shpenzimet e "Shoqerise".

Letra qe duhet te bjere ne doren e aksionareve apo te njihet prej tyre, te pakten 15 dite perpara mbledhjes se Asamblese, percakton diten, oren dhe vendin ku behet mbledhja, si dhe natyren e jashtezakonshme, te zakonshme apo te vecante dhe rendin e dites.

Cdo mbledhje e Asamblese qe thirret ne menyre te parregullt, mund te anullohet.

Megjitheate veprimi i anullimit nuk pranohet, kur te gjithe aksionaret jane prezent apo te perfaqesuar.

## Neni 30

## Percaktimi i rendit te dites

Rendi i dites i mbledhjeve te Asamblese se aksionareve, percaktohet nga autori i lajmerimit.

Megjithate, nje apo disa aksionareve, qe perfaqsojne te [illegible] 5 perqind te kapitalit, u njihet e drejta per te futur ne rendin e dites disa projektrezoluta.

Keto projektrezoluta, dergohen ne seline e "Shoqerise", te shoqeruara me shkresen percjellese dhe me dokumentin ku vertetohet zoterimi apo perfaqesimi i pjeses se kapitalit te kerkuar, sipas paragrafit te dyte te ketij neni.

Asambleja nuk mund te shqyrtoje nje ceshtje, qe nuk percaktohet ne rendin e dites. Megjithate ajo mund te shkarkoje nje apo disa antare te Keshillit Mbikqyres dhe te procedoje per zevendesimin e tyre ne cdo rrethane.

Rendi i dites i mbledhjes se Asamblese, nuk mund te ndryshohet ne lajmerimin e dyte.

Neni 31

Perfaqesimi i nje aksionari

Nje aksionar mund te perfaqesohet nga nje tjeter aksionar, apo nga bashkeshorti.

Cdo aksionar, mund te marre kompetencat qe i japin aksionaret e tjere me qellim qe t'i perfaqesoje ata ne mbledhjen e nje Asambleje pa kufizime te tjera, perveç atyre, qe rrjedhin nga dispozitat ligjore apo nga Statuti, duke percaktuar numrin maksimal te votave, qe mund te zoteroje i njejti person, qofte ne emer te tij, qofte si mandatmbajtes.

Mandati jepet vetem per nje mbledhje Asambleje. Ai nderkaq mund te jepet per dy mbledhje Asambleje, nga te cilat, nje e zakonshme dhe tjetra e jashtezakonshme, qe mbahen ne te njejten dite, ose brenda shtate ditesh.

Mandati i dhene per nje mbledhje Asambleje, eshte i vlefshem per mbledhje te tjera te Asamblese, te cilat thirren ne vazhdim me te njejtin rend dite.

Klauzolat qe bien ne kundershtim me rregullat e paragrafeve te mesiperm, konsiderohen te pavlefshme.

## Neni 32

### Venia ne dispozicion e dokumentave perpara mbledhjes se Asamblese

Drejtoria, duhet te pakten 15 dite perpara dates se mbledhjes se Asamblese, t'u dergoje apo t'u vere ne dispozicion aksionereve dokumentat e nevojshme, per t'u bere te mundur atyre, te njihen dhe te japin gjykim te plote, mbi administrimin dhe ecurine e puneve te "Shoqerise".

Keto dokumenta permbajne vecanerisht :

1. Rendin e dites te mbledhjes se Asamblese.

2. Tekstin e projektrezolutave te paraqitura.

3. Nje pasqyre permbledhese, te gjendjes se "Shoqerise", gjate vitit financiar qe ka kaluar, e shoqeruar me nje tabele, ku jepen rezultatet e cdo viti financiar per 5 vjetet e fundit.

4. Raportin e eksperteve kontabel te autorizuar, i cili ne se eshte i nevojshem, do t'i paraqitet Asamblese, kur behet fjale per ne mbledhjen te jashtezakonshme te saj.

Ne rast se rendi i dites perfshin emerimin e antareve te Keshillit Mbikqyres, jepen edhe :

a) Emri, mbiemri dhe mosha e kandidateve, te dhenat profesionale dhe aktiviteti i tyre profesional, gjate 5 vjeteve te fundit, vecanerisht funksionet qe ushtrojne apo kane ushtruar, ne shoqerite e tjera.

b) Punet qe kryejne dhe funksionet qe zene kandidatet ne "Shoqeri" dhe numrin e aksioneve qe ata kane ne "Shoqeri".

Duke u nisur nga dokumentet e siperpermendura ne kete nen, cdo aksionar ka te drejte te beje pyetje me shkrim, te cilave drejtoria duhet t'u jape pergjigje gjate mbledhjes se Asamblese.

Neni 33

E drejta e votes qe kushtezohet me regjistrimin e aksionarit

E drejta per te marre pjese ne mbledhjen e Asamblese, eshte e kushtezuar nga regjistrimi i aksionarit ne regjistrin e aksioneve nominative te "Shoqerise".

Data kufi per kryerjen e ketij formaliteti eshte, 5 dite para dates se mbledhjes se Asamblese.

Neni 34

Pjesemarrja ne mbledhjet e Asamblese se zakonshme

Te drejten e pjesemarrjes ne mbledhjen e Asamblese se zakonshme e kane aksionaret qe kane nje numer minimun prej 10 aksionesh.

Disa aksionar mund te bashkohen per te arritur minimumin e parashikuar ne Statut dhe per t'u perfaqesuar nga njeri prej tyre.

Neni 35

Pjesemarrja ne mbledhjet e Asamblese se jashtzakonshme

Cdo aksionar mund te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se jashtezakonshme. Cdo klauzole e kundert konsiderohet e pavlefshme.

Neni 36

Pjesemarrja e antareve te organeve drejtuese dhe te e ekperteve kontabel te autorizuar.

Antaret e Keshillit Mbikqyres, antaret e drejtorise dhe eksperret kontabel te autorizuar mund te marrin pjese ne te gjitha mbledhjet e Asamblese se aksionareve me vota konsultative. Ata duhet te njoftohen me shkrim brenda afatit qe percaktohet ne

nenin 29. Ata kane vote vendimore vetem kur e zoterojne ate me cilesine e aksionareve.

## Neni 37

### Evidenca e pjesemarrjes dhe procesverbali.

Ne cdo mbledhje te Asamblese plotesohet nje evidence pjesemarrje. Ecuria e mbledhjes se Asamblese pasqyrohet ne procesverbal. Shenimet qe mbahen ne evidencen e pjesemarrjes dhe ne procesverbal si dhe rregullat e ruajtjes se tyre percaktohen me [illegible] te vecante.

## Neni 38

### Numri i votave.

E drejta e votes qe rrjedh nga zoterimi i aksioneve, eshte proporcionale me pjesen e kapitalit qe ato perfaqsojne dhe cdo aksion te jep te drejten e nje vote.

## KREU V

## NDRYSHIMI I KAPITALIT THEMELTAR

## Neni 39

Ndryshimi i kapitalit themeltar behet sipas seksionit VI, KREU V, te ligjit "Per Shoqerite Tregtare te Republikes se Shqiperise".

## KREU VI

## KONTROLLI I "SHOQERISE" ANONIME

## Neni 40

Ne "Shoqeri" kontrolli ushtrohet nga tre eksperte kontabel te autorizuar.

Ekspertet kontabel te autorizuar emerohen nga Asambleja e

zakonshme. Ajo emeron nje ose disa zevendes eksperte kontabel te autorizuar, qe thirren per te zevendesuar titullaret ne rastet e mospranimit, dorheqjes ose vdekjes.

Ekspertet kontabel te autorizuar emerohen per nje vit financiar. Funksionet e tyre perfundojne pas mbledhjes se Asamblese se zakonshme, e cila merr vendim mbi llogarite vjetore.

Ekspertet kontabel te autorizuar garantojne qe llogarite jetore jane te rregullta dhe te hartuara me sinqeritet dhe japin nje pasqyrim besnik te rezultatit te operacioneve te vitit te kaluar financiar, si dhe te gjendjes financiare e te trashegimnise se "Shoqerise" ne fund te ketij viti financiar. Ekspertet kontabel te autorizuar sigurohen qe eshte respektuar barazia ndermjet aksionarve.

Ne cdo kohe te vitit, ekspertet kontabel te autorizuar, sebashku ose vec e vec, bejne te gjitha verifikimet e kontrollet qe i gjykojne te nevojshme dhe mund te shqyrtojne ne vend te gjithe dokumentacionin e vlersuar si te dobishem ne ushtrimin e detyres se tyre dhe ne vecanti te gjitha kontratat, librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e procesverbaleve.

Ekspertet kontabel te autorizuar, u bejne te njohur drejtorise dhe Keshillit Mbikqyres :

1. Kontrollet dhe verifikimet qe kane kryer dhe sondazhet e ndryshme qe kane bere.

2. Pjeset e bilancit dhe te dokumentave te tjera te kontabilitetit ne te cilat sipas tyre duhet te ishin bere ndryshime, duke bere gjithashtu edhe te gjitha verejtjet e duhura mbi metodat e vlersimit te perdorura ne perpilimin e ketyre dokumentave.

3. Parregullshmerite dhe pasaktesite qe kane zbuluar.

4. Perfundimet qe rrjedhin nga verejtjet dhe korigjimet e mesiperme mbi rezultatet e vitit financiar, te krahasuara me ato te vitit financiar te meparshem.

Ekspertet kontabel te autorizuar thirren ne mbledhjen e drejtorise, e cila mbyll llogarite e vitit te kaluar financiar, si dhe ne te gjitha mbledhjet e Asamblese se aksionareve.

Ekspertet kontabel te autorizuar sinjalizojne ne mbledhjen me te afert te Asamblese, parregullshmerite dhe pasaktesite e gjetura nga ata gjate ushtrimit te detyres se tyre. Pervec kesaj ata i zbulojne prokurorit te Republikes se Shqiperise, faktet qe perbejne krim, per te cilat ata kane marre dijeni. Me perjashtim te rasteve te mesiperme, ekspertet kontabel te autorizuar, si dhe bashkepunetoret e ekspertet e tyre, detyrohen te ruajne si sekret profesioni faktet, aktet dhe informacionet, per te cilat kane mundur te vihen ne dijeni per shkak te funksioneve te tyre.

Ekspertet kontabel te autorizuar jane pergjegjes si ndaj "Shoqerise" ashtu dhe ndaj te treteve per pasojat e demshme qe rrjedhin nga fajet dhe nenvleftesimet e tyre ne ushtrimin e funksioneve perkatese.

Honoraret e ekspertеve kontabel te autorizuar i ngarkohen "Shoqerise", Asambleja ne aktin e emerimit percakton edhe madhesine e honorarit.

## KREU VII

## PRISHJA E "SHOQERISE" ANONIME

### Neni 41

### Prishja nga Asambleja e jashtezakonshme.

Prishja e "Shoqerise" shpallet ne mbledhjen e Asamblese se jashtezakonshme, kur :

a) Ortake jane vetem dy (themeluesit e permendur ne nenin 1 te ketij Statuti),

- me kerkesen e njerit prej ortakeve, kur ajo behet nje vit perpara deri ne fund te vitit te ardheshem kalendarik. Ne kete rast prishja e "Shoqerise" nuk mund te behet me perpara se 25 vjet nga dita e regjistrimit te saj.

b) behet privatizimi i te dy ortakeve,

- ne baze te vendimit te Asamblese se jashtezakonshme te aksionareve me nje shumice votash prej 3/4.

Pas prishjes se "Shoqerise" ortakèt marrin :

a) per kontributet e vena, sipas nenit 6 te ketij Statuti, kuoten te barabarte me vleren nominale te aksioneve te poseduára.

b) kuoten e vleres se pasurise se mbetur te vlersuar nga nje komision i pavarur, proporcionalisht me aksionet qe posedojne.

### Neni 42

### Prishja per humbje aktivi.

Ne qofte se si rrjedhim i humbjeve te konstatuara ne dokumentet kontabel kapitalet e "Shoqerise" behen me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, drejtoria detyrohet, brenda 4 muajve nga miratimi i bilancit financiar ku eshte zbuluar kjo humbje, te therrase mbledhjen e Asamblese se jashtezakonshme, me qellim qe te merret vendimi, nese ka vend per prishjen.

## KREU VIII

## PERGJEGJESIA LIGJORE

### Neni 43

Pergjegjesia ligjore e themeluesve te "Shoqerise", aksionareve, antareve te drejtorise dhe anetareve te Keshillit Mbikqyres percaktohet sipas dispozitave te Seksionit X Kreu V te ligjit "Per Shoqerite Tregtare te Republikes se Shqiperise".

## KREU IX

## RAPORTET VJETORE

### Neni 44

Dokumentet e llogarise qe vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar.

Ne mbylljen e cdo viti financiar drejtoria ben inventarin dhe llogarite vjetore, ne perputhje me dispozitat legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin, si dhe harton nje raport me shkrim per administrimin. Bilancit i bashkangjiten :

1. Nje situacion mbi garancite e dhena nga "Shoqeria".
2. Nje situacion mbi sigurimet e bera nga "Shoqeria".

Raporti i administrimit pasqyron gjendjen e "Shoqerise" gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara te saj, veprimtarite e rendesishme qe jane zhvilluar gjate periudhes nga data e mbylljes se vitit finaciar deri ne daten ne te cilin eshte hartuar ky raport.

Dokumentet e permendura ne kete nen, vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar ne seline e "Shoqerise" te pakter nje muaj perpara mbledhjes se Asamblese, te thirrur per te vendosur mbi llogarite e "Shoqerise". Me kerkese te tyre nje kopje te dokumentave u jepet ketyre eksperteve.

Neni 45

Rezerva e domosdoshme.

Nga fitimi i rezultuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjet e vitit te meparshem, lihet menjane nje shume me te pakten 8 perqind e fitimit neto, e cila destinohet per formimin e nje fondi rezerve, te quajtur "rezerve e domosdoshme". Cdo vendim i kundert eshte i pavlefshem.

Kjo lenie menjane nuk eshte me e detyrueshme kur "rezerva e domosdoshme" arrin 1/3 e kapitalit themeltar.

Neni 46

Asambleja e zakonshme ne rast nevoje mund te formoje fonde te tjera, pervec fondit te caktuar ne nenin 45 te ketij Statuti. Pas plotesimit te shumes se fondeve te mesiperm, pjesa e mbetur e fitimit caktohet per ndarje per aksionaret ne formen e dividenteve.

Neni 47

Fitimi qe do te shperndahet.

Fitimi qe do te shperndahet, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerve sipas statutit dhe nga ana tjeter, jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e me parshme.

Asambleja mund te marre vendim qe te shperndahen shumat e

lena menjane per rezerven qe ajo ka ne dispozicion. Ne kete rast vendimi tregon shprenimisht llojet e rezerves ku jane marre keto shuma. Pervec rastit te zvogelimit te kapitalit te parashikuar ne ligjin "Per Shoqerite Tregtare te Republikes se Shqiperise" asnje shperndarje nuk mund t'u behet aksionareve, ne qofte se kapitalet e veta jane ose do te beheshin mbas kesaj shperndarje me te vegjel se shuma e kapitalit te cilit i shtohen rezervat qe Statuti nuk i lejon te shperndahen.

## Neni 48

## Percaktimi i dividenteve, dividenti fiktiv.

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidencimit te ekzistences se shumave qe do te shperndahen, Asambleja percakton pjesen qe u takon aksionarve ne forme dividentesh.

Cdo divident i shperndare, duke shkelur keto rregulla, perben nje divident fiktiv.

Megjithate nuk perbejne dividente fiktiv paradhenijet, vlera e te cilave ka rrjedhur nga vitet financiare te mbyllura, ose ne vazhdim, te cilat jane derdhur perpara se te jene miratuar llogarite e ketyre viteve financiare me kusht qe :

1. "Shoqeria", pervec rezerves se domosdoshme te kete ne dispozicion rezerva me nje shume te pakten te njejte me paradhenijet e shperdara ose qe raport vertetimi i bere nga nje ekspert kontabel i autorizuar te beje te njohur fitime neto me te medha se shuma e paradhenieve.

2. Shperndarja e paradhenieve te vendoset nga drejtoria, qe percakton shumen dhe daten e kthimit.

Neni 49

Reklamimi i dividenteve.

"Shoqeria" nuk mund t'u kerkoje aksionareve asnje reklamim dividentesh, me perjashtim te rastit kur plotesohen te dy kushtet e meposhteme :

1. Ne qofte se shperndarja eshte bere duke shkelur rregullat e neneve 47 dhe 48 te ketij Statuti.

2. Ne qofte se "Shoqeria" verteton se perfituesit kishin dijeni per karakterin jo ne perputhje me Statutin te kesaj shperndarje ne momentin e realizimit ose qe ata ne rrethanat konkrete nuk mund te mosmerrnin parasysh kete parregullshmeri.

KREU X

L I K U J D I M I

Neni 50

Likujdimi i "Shoqerise" rregullohet duke zbatuar dispozitat e ligjit "Per Shoqerite Tregtare te Republikes se Shqiperise".

KREU XI

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 51

Ceshtjet qe kane te bejne me aksionet dhe letrat me vlere do te gjejne zbatim pas krijimit te institucioneve dhe organizmave perkatese ne Republiken e Shqiperise.

Neni 52

Te gjithe ceshtjet qe nuk permenden ne kete Statut dhe qe kane te bejne me "Shoqerine", rregullohen sipas dispozitave te ligjit "Per Shoqerite Tregtare te Republikes se Shqiperise".

Neni 53

Marrëdheniet e "Shoqerise" me sindikatat rregullohen sipas legjislacionit Shqiptar.

Neni 54

MENYRA E ZGJIDHJES SE MOSMARRVESHJEVE

1) Cdo mosmarrveshje ndermjet paleve ne fjale qe i perket interpretimit ose zbatimit te ketij Statuti do te zgjidhet prej paleve ne rrugen e mirekuptimit.

2) Ne rast se nje mosmarrveshje e tille nuk zgjidhet ne nje afat prej tre muajsh, duke e llogaritur nga dita ne te cilen njera [illegible] propozuar zgjidhjen me mirekuptim atehere pala e interesuar mund t'a ngreje kete mosmarrveshje perpara Gjyqit te Arbitrazhit Nderkombetar prane Dhomes Nderkombetare te Tregtise ne Paris (me emerin Chambre de Commerce Internationale D'Arbitrage, me seli [illegible] Albert 1-er 75.008 Paris).

Gjyqi i arbitrazhit cakton menyren e vet te veprimit duke perdorur parimet aktuale te veprimit te arbitrazhit te Komisionit [illegible] per ceshtjet e se Drejtes Nderkombetare ne Tregti ( UNICTRAL ), qe eshte ne fuqi ne kohen e nenshkrimit te ketij Statuti.

Vendimi i Gjyqit te Arbitrazhit do te jete i detyrueshem per te dy palet.

3. Menyra e thirrjes se Gjyqit te Arbitrazhit.

3.1. Cdo pale cakton nje arbiter dhe keta dy arbitra zgjedhin [illegible] kryetar te nje shteti te trete. Arbitrat do te caktohen brenda nje muaji, ndersa kryetari brenda tre muajve nga dita kur njera nga palet ka informuar palen tjeter per qellimin qe ka ajo per t'a kaluar mosmarrveshjen ne Gjyqin e

Arbitrazhit.

3.2. Ne rast se njera nga palet nuk ben zgjedhjen e arbitrit te saj ne afatin e caktuar, atehere pala tjeter mund t'i drejtohet me lutje Kryetarit te Gjyqit Nderkombetar te Arbitrazhit prane Dhomes Nderkombetare te Tregtise ne Paris, per emrimin e arbitrit te domosdoshem.

3.3. Cdo pale mbulon shpenzimet e emerimit prej saj te arbitrit dhe shpenzimet e marrjes pjese ne arbitrazh.

Shpenzimet e Kryetarit si dhe shpenzimet e tjera i mbulojne palet ne pjese te barabarta.

Neni 55

Te gjithe shpenzimet lidhur me regjistrimin e "Shoqerise" i mbulojne themeluesit e saj, proporcionalisht me vleren e aksioneve

Neni 56

"Shoqeria" i shpall njoftimet e saj ne gazetat e autorizuara per publikime dhe lajmerime zyrtare ne Shqiperi dhe Poloni.

Neni 57

Kopje te ketij statuti mund t'i jepen organeve te "Shoqerise" ne sasi te pakufizuar.

Neni 58

Ky Statut perpilohet ne tre ekzemplare orgjinale ne gjuhen shqipe, polake dhe angleze dhe te gjitha tekstet jane njelloj autentike, prej te cileve sejcila pale merr nga nje ekzemplar ndersa ekzemplari i trete depozitohet ne Ministrine e Tregetise dhe Bashkepunimit Ekonomik me Jashte te Republikes se Shqiperise.

Ne rast mosmarrveshjesh ne interpretim, teksti ne anglisht do jete percaktues.